

KOMENTIMI I SURES FATIHA



HOXHË LULZIM PERÇUKU

Titulli i librit:
“Komentimi i sures Fatiha”

Ligjëroi:
Hoxhë Lulzim Perçuku

Kontrollloi:
Hoxhë Lulzim Perçuku

Transkriptoi:
Albiona Olluri

Kopertina dhe faqosja:
Denisa Zeqiri

Prill, 2025

SURJA FATIHA ËSHTË SURJA MË E VLEFSHME NË KURAN

El Fatiha, është quajtur nga i Dërguari (salAllahu alejhi ue selem): **“Nëna e Kuranit (baza e tij)”**, ngase nëse meditojmë rreth kuptimeve të Kuranit shohim se i gjithë Kurani është shpjegim/komentim i sures Fatiha. Dijetarët thonë: *“I gjithë Kurani është i përmbledhur në suren Fatiha.”* Ibn Kajjim (rahimehullah) thotë: *“Pozitat e atyre që ecin drejt Allahut i hasim në një ajet: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.” (Fatiha 4) Dije se surja Fatiha në mënyrën më të përkryer, përmban në vete qëllimet më të larta që ka besimtari.”* Medarixhus salikin. Pra, njerëzit dallojnë në pozitat/nivelet që arrijnë tek Allahu, për aq sa arrijnë ta realizojnë këtë ajet. Ajo është surja më e vlefshme në Kuran.

Disa prej sekteve në Islam thonë se nuk lejohet të thuhet: “Disa sure të Kuranit janë më të vlefshme sesa disa të tjera”, mirëpo janë të shumta hadithet dhe etheret që tregojnë të kundërtën dhe që dëshmojnë për akiden e saktë të ehli sunetit (pasuesve të sunetit): se disa fjalë të Allahut janë më të vlefshme sesa disa fjalë të tjera të Tij. I Dërguari (salAllahu alejhi ue selem) thotë: **“As në Teurat, as në Inxhil, as në Zebur dhe as në Kuran (pjesën tjetër të**

“As në Teurat, as në Inxhil, as në Zebur dhe as në Kuran (pjesën tjetër të tij) nuk ka zbritur sure e ngjashme me të (suren Fatiha).” (*Ahmedi dhe Tirmidhiu.*)

Ajo është surja më e përgjithshme e cila përfshin gjërat e dobishme për besimtarin në këtë botë dhe tjetrën.

Kurani madhështor përmban 114 sure. E para është Fatiha, pozitën e së cilës Allahu e ka ngritur shumë lartë në shumë ajete të Kuranit, prej tyre:

“Ne të kemi shpallur shtatë vargje që përsëriten dhe Kurani e madhërisëm.” (*Hixhr 87*)

Pejgamberi (salAllahu alejhi ue selem) ka thënë për të se ajo është surja më madhështore në Kuran, pastaj ka thënë: **“(Nëna e Kuranit - El Fatiha) Është shtatë ajetet që përsëriten dhe Kurani madhështor që më është dhënë mua.”** (*Buhariu*)


Mirëpo, ku jemi ne në raport me suren Fatiha? Sa po e përjetojmë dhe sa po përsiatim mbi të?

Suren El-Fatiha jemi urdhëruar ta lexojmë në çdo rekat të namazit, madje ajo është prej shtyllave të namazit, që nëse dikush e harron ta thotë në namaz qoftë nga harresa apo me qëllim, namazi i zhvlerësohet dhe duhet ta përsërisë. Ajo është ushqim për zemrën e besimtarit, për të cilin ka nevojë çdoherë.

Duke qenë se ajo ka pozitë kaq të rëndësishme, atëherë besimtari patjetër duhet ta mësojë kuptimin e saj, të meditojë në të dhe të punojë me atë që kërkon ajo. Po ashtu, kur ne mësojmë kuptimet e sures Fatiha, kjo do të jetë prej shkaqeve të faljes së namazit me përulje. Surja Fatiha përmban shumë kuptime të larta dhe madhështore. Prej tyre:


- ♦ Përfshin lavdërimin, falenderimin dhe madhërimin ndaj Allahut.
- ♦ Përmendet kthimi tek Allahu në Ditën e Gjykimit-Shpërblimit.
- ♦ Përfshin Ihlasin – se të gjitha adhurimet duhet t'i kushtohen vetëm Allahut singërisht, dhe përfshin teuhidin – veçimin e Allahut me adhurimet tona.
- ♦ E lartëson Allahun nga vënia ortak në adhurimin ndaj Tij apo nga ngjashmëria a krahasimi i dikujt me Atë.
- ♦ Na mëson se ndihma (në të gjitha çështjet e fesë dhe të dunjasë) është vetëm prej Allahut dhe se vetëm prej Tij duhet të kërkohet.
- ♦ Na mëson ta lusim Allahun të na japë udhëzimin në rrugën e drejtë (e cila është feja e vërtetë).
- ♦ Na nxit për shtimin e veprave të mira në mënyrë që të jemi me punëmirët në Ditën e Gjykimit.
- ♦ Paralajmëron besimtarët që të mos ndjekin rrugët e së kotës.

KOMENTIMI I SURES FATIHA: SURJA HAPËSE E KURANIT



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ


“Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!”



Besmele është ajet i veçantë i Kuranit, të cilin Allahu e ka vendosur në fillimin e sureve të Kuranit, përveç sures Teube, dhe këtu hyn edhe surja Fatiha. Sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, besmele nuk është ajet i sures Fatiha.


“**Bismilah** - Me emrin e Allahut” d.m.th: Filloj leximin e saj duke kërkuar ndihmën dhe bereqetin me çdo emër të bukur të Allahut.¹

¹ Emrat e Allahut: Err-Rrahman dhe Err-Rrahim, do të shpjegohen më poshtë.



الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“Çdo lavdërim i përket
Allahut, Zotit të botëve”



Hamd – lavdërimi është përshkrimi i të Lavdëruarit me përsosmëri duke ia bashkëngjitur *dashurinë dhe madhërimin* ndaj Tij. Kjo i takon vetëm Allahut. Ne duhet ta bëjmë hamd Allahun për shkak se Ai është i përsosur në Qenien, Emrat, Cilësitë dhe në Veprat e Tij dhe për shkak të mirësive e dhuntive të shumta që na ka dhënë. Lavdërimi bëhet me zemër dhe me gjuhë. Të gjitha lavdërimet i takojnë Allahut dhe vetëm Ai i meriton ato.

Allahu është i lavdëruar në *ilahijen* e Tij (Ai është i vetmi që meriton adhurimin), në *rububijen* e Tij (Ai është i vetmi që e zotëron dhe drejton universin) dhe për *Mëshirën* e Tij (Ai është i Mëshirshëm dhe i mëshiron krijesat e Tij).

Siç e dimë, **All-llah** është Emër i Zotit të botëve dhe askush nuk lejohet të quhet me këtë emër. **All-llah** do të thotë: *I Adhuruar me dashuri dhe me madhërim*. Ky emër është baza e të gjithë emrave të tjerë të Tij, të


të cilët i atribuohen atij apo e pasojnë atë (emrin **Allah**).

Er-Rab - Zoti është Ai tek i Cili janë bërë bashkë tri Cilësi: Krijimi, sundimi dhe drejtimi i krijimit. Allahu është er Rab - Zoti i krijesave, d.m.th. kujdeset për to.² Ai në përgjithësi kujdeset për të gjitha krijesat dhe në veçanti kujdeset për miqtë e Tij - besimtarët e devotshëm (duke i udhëzuar në besim, duke iu dhënë sukses drejtë të mirave dhe duke i mbrojtur nga të këqijat). Allahu është mbrojtësi, ndihmuesi dhe kujdestari më i mrekullueshëm për besimtarët.

Dhe çdo gjë tjetër, përveç Allahut, quhet aalemin.³ Allahu është Zoti i botëve, sepse Ai i ka krijuar ato. Zotërimi i Allahut ka përfshirë të gjitha krijesat.


² I krijon, pastaj iu përgatit mjete e rrugë që janë në dobinë e tyre, i begaton me mirësi të shumta e madhështore etj.

³ Marrë prej fjalës alem që tregon se të gjitha krijesat janë shenja që aludojnë për Krijuesin e tyre dhe se universi e ka një Krijues. Në çdo krijesë është një shenjë dhe argument që dëshmon për Krijuesin, i Cili është i Plotfuqishëm, i Urtë, Mëshirues, i Gjithëpushtetshëm etj.



الرَّحْمَنُ الرَّحِيمُ

“të Gjithëmëshirshmit,
Mëshiruesit”



Err-Rrahman është Ai i Cili posedon mëshirën e gjerë e të madhe (gjithëpërfshirëse). Allahu me Mëshirën e tij ka përfshirë të gjitha krijesat. Nga ky emër përfitojmë se *Mëshira është Cilësi e Qenies së Allahut*. Ai është i mëshirshëm në Qenien e Tij. Mëshira të cilën Allahu e pohon për Vetën e Tij është reale, e vërtetë, dhe për të dëshmon Kurani, suneti dhe logjika e shëndoshë.

Err-Rrahim është Ai i Cili i mëshiron robërit të Tij (kjo është Vepër e Tij). Ky emër tregon se Allahu vepron me këtë cilësi, domethënë i mëshiron krijesat e Tij.


Përderisa Allahu është i Mëshirshëm dhe si Cilësi të Tij ka Mëshirën, atëherë patjetër që do t'i mëshirojë robërit e Tij. Andaj, kurrë mos e humb shpresën në Mëshirën e Allahut.

Kur të kaplojnë brengat e vështirësitë dhe të rrethojnë sprovat, atëherë kur të falësh namazin do

të kujtosh (gjatë leximit të sures Fatiha) se Allahu është *i Gjithëmëshirshmi* dhe *Mëshiruesi*, dhe kështu të largohen brengat dhe zemra të mbushet me shpresë e me mendim të mirë ndaj Allahut.


Mëshira e Allahut ka përfshirë të gjitha krijesat në këtë univers, edhe besimtarët edhe jobesimtarët, edhe të devotshmit edhe mëkatarët. Ai, disa prej robërve të Tij, i veçon me Mëshirë në të dy botët, e disa vetëm në këtë dunja (jobesimtarët).

Pse Allahu pas ajetit: **“Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve”**, sjell ajetin **“të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit”**? Allahu me këtë ka dashur të na tregojë se zotërimi i Tij është i bazuar në Mëshirën e Tij.



مَلِكِ يَوْمِ الدِّينِ

“Sunduesit të Ditës së
Gjykimit”



Në atë Ditë njerëzit do të shpërblehen në bazë të veprave të tyre. Allahu është Sunduesi i kësaj Dite në të cilën do t'i shpërblejë njerëzit dhe xhindët. Askush tjetër përveç Allahu nuk do ta sundojë atë Ditën, por gjithashtu askush tjetër përveç Tij nuk i sundon ditët e kësaj bote.

Sundimi i Allahut është i vërtetë. Allahu është *Mbreti, Zotëruesi dhe Sunduesi* - në Dorën e Tij është drejtimi i universit.

Nën Sundimin e Allahut është Dita e Gjykimit, ndërsa të gjitha sundimet e mbretëritë e tjera do të shkatërrohen. Atë Ditë do të shfaqet Sundimi i Allahut dhe çdokush do ta pranojë atë.⁴ Ndërsa, në këtë dunja ka njerëz që nuk e besojnë Allahun, por besojnë të tjerë për zot dhe i konsiderojnë si sundues të vërtetë.

⁴ Kjo është arsyeja pse është veçuar sundimi i Allahut me Ditën e Gjykimit.

Allahu thotë: **“Kujt i përket pushteti i asaj dite? Allahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!”** (*Gafir 16*)

Sa herë që e lexojmë këtë ajet gjatë sures Fatiha, duhet të paraqitet para nesh kjo Ditë, që të mos tregohemi të shkujdesur e të pavëmendshëm për të.

Ajo që duhet të na brengosë është çështja se ku janë zemrat tona në raport me këtë Ditë? Ne duhet ta lusim Allahun të zgjojë zemrat tona prej shkujdesjes dhe ta lexojmë këtë ajet me përvullje e përqendrim.

Në ajet pohohet ringjallja dhe shpërblimi. Njerëzit patjetër do të ringjallen dhe do të takohen me Allahun, Sunduesin e Ditës së Gjykimit, dhe Ai do t'i shpërblejë në bazë të veprave që kanë bërë. Ky ajet nxit përgatitjen për këtë Ditë duke bërë vepra të mira dhe duke u larguar nga ndalesat.

Tri ajetet e para të sures Fatiha na njoftojnë me të Adhuruarin tonë - Allahun, përmes tre Emrave të bukur të Tij, që janë: Allah, Rab dhe Rrahman, tek të cilët kthehen të gjithë Emrat e tjerë të Tij.

Kjo sure është e bazuar mbi ilahijen (se Allahu i Vetmi e meriton adhurimin), mbi rububijen (se Allahut të Vetmit i takon sundimi dhe zotërimi i universit) dhe mbi Mëshirën (se Allahu është i Gjithëmëshirshmi).


Kjo sure përfshin tre llojet e teuhidit. Sa i përket teuhidit *Uluhije*, për të tregon emri **Allah** që do të thotë: I Adhuruari, me dashuri dhe me madhërim. Për teuhidin *Rububije* tregon emri **Er Rrab** – Zoti, Krijuesi, drejtuesi i universit. Për teuhidin e *Emrave dhe Cilësive të Allahut* tregojnë po këta emra: **Allah, Rrab, Rrahman, Rrahim, Melik**.

Kjo sure përfshin gjithashtu tri bazat e adhurimit, që janë:

* *Dashuria*, tek ajeti i parë: “**Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve**”, ne e bëjmë hamd Allahun sepse e duam dhe e madhërojmë dhe sepse është i përsosur. Lavdërimi i shoqëruar me dashuri dhe madhërim quhet hamd.


* *Shpresa*, tek ajeti i dytë: “**të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**”, ngase këta dy emra tregojnë se Allahu ka mëshirë të madhe e të gjerë dhe vazhdimisht i mëshiron krijesat (në përgjithësi dhe në veçanti). Allahu është i Vetmi prej të Cilit duhet të shpresojmë Mëshirën, faljen etj.

* *Frika*, tek ajeti i tretë: “**Sunduesit të Ditës së Gjykimit**”, ngase ajo është Dita e shpërblimit, në të cilën do të japim llogari.



إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ

**“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm
prej Teje ndihmë kërkojmë.”**



Do të thotë: Ty të adhurojmë e askënd tjetër përveç Teje dhe prej Teje kërkojmë ndihmë e prej askujt tjetër përveç Teje.

“Vetëm Ty të adhurojmë” - të përulemi në formën më të plotë.

Këtu përmendet së pari adhurimi (e përgjithshmja), pastaj kërkimi i ndihmës (e veçanta), duke i kushtuar rëndësi më shumë të drejtës së Allahut (adhurimit ndaj Tij), pastaj të drejtës së njeriut (kërkimit të ndihmës tek Ai).

Edhe kërkimi i ndihmës tek Allahu është pjesë e adhurimit ndaj Tij. Mirëpo, Allahu e veçon kërkimin e ndihmës këtu, për të na treguar se të gjithë njerëzit janë nevojtarë që Ai t’iu ndihmojë në adhurimet që bëjnë. Nëse Allahu nuk na ndihmon të kryejmë adhurimet ndaj Tij (zbatimin e obligimeve dhe largimin nga ndalesat), atëherë nuk mundemi kurrë t’i kryejmë ato.

Adhurimi është fjalë që përfshin çdo vepër dhe fjalë, të brendshme apo të jashtme, me të cilat Allahu është i kënaqur dhe i do ato. Ndërsa, kërkimi i ndihmës është mbështetja tek Allahu (e jo te vetja) në arritjen e dobive dhe largimin e dëmeve, duke pasur bindje të plotë.

Adhurimin tonë duhet ta bëjmë sinqerisht vetëm për Allahun (**“Vetëm Ty të adhurojmë”**), po ashtu edhe ndihmën duhet ta kërkojmë vetëm prej Allahut (**“vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**).⁵ Ky kërkim ndihme është prej adhurimit, andaj duhet t'i drejtohet vetëm Allahut.

Adhurimi ndaj Allahut dhe kërkimi i ndihmës tek Ai është rruga e vetme për arritjen e lumturisë së përhershme dhe shpëtimin prej çdo të keqeje. Për t'u pranuar adhurimi tek Allahu duhet të jetë i bazuar në sunetin e Pejgamberit (salAllahu alejhi ue selem) dhe të ketë qëllim shikimin e Fytyrës së Allahut në Xhenet (të jetë i sinqertë për Atë).


⁵ Ndërsa, kërkimi i ndihmës prej njerëzve ka disa kushte, si: të jetë i gjallë, i pranishëm dhe të ketë mundësi të të ndihmojë. Nëse krijesa nuk ka mundësi të plotësojë kërkesën tënde, atëherë nuk lejohet kërkimi i ndihmës prej saj, madje në disa raste mund të jetë shirk i madh (p.sh.. kërkimi i ndihmës prej të vdekurve në varre, sepse i vdekuri nuk mund ta ndihmojë as vetën e vet, apo kur kërkon ndihmë nga dikush që nuk është prezent dhe nuk mund të të ndihmojë, si: kur dikush kërkon ndihmë prej prijësit të sektit edhe nëse ai është larg).

Tek ajeti “**Vetëm Ty të adhurojmë** (askënd tjetër përveç Teje)” kemi realizimin e kuptimit të fjalës *La ilahe il-lAllah*, ngase ajo është e përbërë nga *mohimi* (La ilahe - mohohen të gjithë të adhuruarit e tjerë që adhurohen krahas Allahut) dhe *pohimi* (il-lAllah - pohohet se adhurimi i takon vetëm Allahut).

Zemrat tona i ekspozohen dy sëmundjeve të rrezikshme, ndaj të cilave nëse nuk tregohemi të kujdesshëm atëherë ato na dërgojnë drejt shkatërrimit, e ato janë: syfaqësia dhe mendjemadhësia. Dhe pikërisht ilaçi për syfaqësinë është pjesa e parë e ajetit: “**Vetëm Ty të adhurojmë**”, ndërsa ilaçi për mendjemadhësinë është te pjesa: “**dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë**”, sepse besimtari pa e pasur ndihmën e Allahut nuk mund të kryejë adhurime. Andaj pse të tregohet mendjemadh kur nuk ka asgjë në dorën e tij?!


Prandaj, lutja më e dobishme është lutja që Allahu të na mundësojë të arrijmë Kënaqësinë e Tij, apo të na mundësojë të veprojmë veprat me të cilat e arrijmë atë. Në anën tjetër, mirësia më e madhe prej Allahut është kur të ndihmon drejt arritjes së këtij qëllimi. Nëse meditojmë në të gjitha lutjet e Kuranit dhe sunetit, shohim se ato vërtiten rreth kësaj çështjeje: Të na mundësojë Allahu të veprojmë vepra me të cilat arrihet Kënaqësia e Tij, apo të na mundësojë të

largohe mi prej gjërave që pengojnë nga kjo. Ibën Tejmije ka thënë: *“Kam medituuar se cila është lutja më e dobishme për njeriun dhe kam parë se ajo është lutja në të cilën ne lutemi që Allahu të na ndihmojë të kryejmë vepra përmes së cilave arrijmë kënaqësinë e Tij, dhe pash se ajo gjendet në suren Fatiha: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”*



أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

“Udhëzoni në rrugën e drejtë!”



Qëllimi me kërkimin e udhëzimit këtu është orientimi në rrugën e drejtë dhe inspirimi e suksesi në ndjekjen e kësaj rruge. Kur thua **“Udhëzoni në rrugën e drejtë”** kërkon prej Allahut të të japë dije të dobishme, prej Kuranit dhe sunetit, ta kuptosh atë dhe të ta mundësojë të veprosh vepra të mira të bazuara në atë dije.

Pasi njeriu kërkon ndihmë tek Allahu ta ndihmojë në adhurimin kushtuar Atij, duhet gjithsesi të kërkojë ta udhëzojë në rrugën e drejtë.

Rruga e drejtë është ajo e cila dërgon tek Allahu dhe te xheneti i Tij. Ajo është kur njeriu njeh të vërtetën dhe punon me të.

Lutja drejtuar Allahut për të na udhëzuar në rrugën e drejtë është prej synimeve më madhështore të besimtarit. Arritja e këtij synimi (të jesh në rrugën e drejtë) është prej mirësive të Allahut ndaj besimtarit. Allahu na ka mësuar se si duhet ta kërkojmë këtë gjë, prandaj së pari na urdhëron të bëjmë hamd

(“Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve”), të thurim lavde për të (“të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”) dhe ta madhërojmë (“Sunduesit të Ditës së Gjykimit”), pastaj na përmend faktin se duhet të jemi robër adhurues ndaj Allahut e të kemi teuhid (“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”).

Këto janë dy rrugë (kërkimi i afrimit tek Allahu përmes Emrave dhe Cilësive të Tij dhe nënshtrimi ndaj Tij)⁶ përmes të cilave besimtari arrin synimet e tij.

Ibën Tejmije (rahimehullah) ka thënë: *“Lutja më e dobishme, më madhështorja dhe më e përsosura, është ajo e cila përmendet në suren Fatiha: “Udhëzona në rrugën e drejtë!”, sepse nëse Allahu të udhëzon në këtë rrugë, atëherë do të të ndihmojë ta adhurosh Atë sa më shumë dhe të braktisësh mëkatet. Kështu pastaj nuk do të të godasë asnjë e keqe, as në këtë botë e as tjetrën. Mirëpo, mëkatet nuk i ndahen njeriut (e ka në natyrë mëkatimin), andaj ka nevojë për udhëzimin e Allahut në çdo çast. Madje, ka nevojë për udhëzim më shumë sesa për furnizim me ushqim e pije.”*⁷

⁶ Sa herë që besimtari i përdor këto dy forma të wesiles (afrimit tek Allahu) gjatë lutjeve të tij, rrallëherë ndodh të mos i pranohen tek Allahu ato lutje.


⁷ Megjithatë shumë muslimanë kur e lexojnë në namaz këtë lutje gjatë Fatihasë, nuk e bëjnë këtë duke e ndje se është lutje.

Kur ne e lusim Allahun të na udhëzojë në rrugën e drejtë, kjo përfshin dhjetë nivele:

1. Të na pajisë me dije e njohuri për rrugën e drejtë.
2. Të na japë mundësi ta ndjekim atë.
3. Të na mundësojë të kemi dëshirë ta ndjekim atë.
4. Të na mundësojë të veprojmë me dijen që kërkon ajo.
5. Të na forcojë në ndjekjen e saj.
6. Të largojë prej nesh pengesat në ndjekjen e saj.
7. Të na mundësojmë të ndjekim këto nivele.
8. Të na mundësojë të jemi të vëmendshëm ndaj synimit të ndjekjes së kësaj rruge.
9. Të na mundësojë të pranojmë nevojën tonë të madhe për udhëzim.
10. Të na mundësojë të dimë dy rrugët e atyre që kanë devijuar nga kjo rrugë e drejtë (ata që nuk e kanë ndjekur qëllimisht atë dhe ata që janë shmangur nga ajo për shkak të injorancës).


Për aq sa këmbët e besimtarit janë të qëndrueshme në këtë rrugë të drejtë në këtë botë, aq do të jenë të qëndrueshme në Siratin e botës tjetër. Për aq sa ecën shpejt në këtë rrugë, aq do të ecë shpejt në Siratin e botës tjetër. Njerëzit do të dallojnë sa i përket kalimit të Siratit në botën tjetër.

Kjo lutje përfshin mirësitë e kësaj bote dhe tjetrës.



صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

**“Në rrugën e atyre që u ke
dhuruar mirësi...”**



Së pari Allahu e ka përmendur në mënyrë të përgjithshme: **“Udhëzona në rrugën e drejtë”**, dhe menjëherë pas kësaj e ka detajuar dhe shtjelluar se cila është kjo rrugë e drejtë: **“Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi”**.


“që u ke dhuruar mirësi” – i ke begatuar me dije të dobishme (prej Kuranit e sunetit) dhe me vepra të mira (zbatim).

Këta janë ata të cilët kanë punuar me atë që kërkon rruga e drejtë, të cilët janë përmendur në ajetin: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët⁸, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”** (Nisa 60)

⁸ Siç ka qenë Ebu Bekri (radijAllahu anhu) dhe të tjerët.


Kur e dëgjojmë këtë sure duhet të meditojmë dhe të përjetojmë disa domethënie, si:

- *Udhëzimi është mirësi e pastër, e kulluar, prej Allahut ndaj njerëzve.*
- *Të kujtosh të udhëzuarit para teje, Pejgamberët, të singertit, dëshmorët, të devotshmit, në mënyrë që të ndjekësh shembullin e tyre.*
- *Të kujtosh se nuk je i vetëm në rrugën e udhëzimit, andaj mos u mërzit nëse të kundërshtojnë apo të bojkotojnë njerëzit.*



غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

**“e jo në të atyre që kanë shkaktuar
zemërimin Tënd, as në të atyre që
janë të humbur”**



Grupi i parë janë ata që e kanë njohur të vërtetën dhe e kanë braktisur atë nga kryeneçësia. Tek ta së pari hyjnë hebrenjtë dhe të tjerët si ta, të cilët e njohin të vërtetën dhe nuk punojnë me të. Kurse të humburit janë ata që nuk e kanë ndjekur të vërtetën për shkak të mosdijes (kanë dije të pasaktë); këta janë së pari të krishterët⁹ dhe të tjerët si ta.¹⁰

Pasi Allahu na urdhëroi ta lusim Atë në çdo namaz për të na udhëzuar në rrugën e drejtë, e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin e Tij e as në të atyre që janë të humbur, atëherë kjo na qartëson se ne duhet të kemi shumë frikë se mos devijojmë sikurse ata.

⁹ Të krishterët para ardhjes së Muhamedit (salAllahu alejhi ue selem), ndërsa ata pas tij e kanë kuptuar të vërtetën por e kanë kundërshtuar atë.

¹⁰ Ky shpjegim është transmetuar në hadithin e saktë prej të Dërguarit të Allahut, (salAllahu alejhi ue selem). Hadithi transmetohet te Suneni i Tirmidhiut.

Njerëzit ndahen në tri grupe:

- 1. Ata që janë të udhëzuar në rrugën e drejtë.**
- 2. Ata mbi të cilët ka rënë Zemërimi i Allahut.**
- 3. Ata që janë të humbur (nga mosdija).**

Shkaqet prej të cilave njerëzit dalin nga rruga e drejtë janë dy: *inati e kryeneçësia dhe mosdija*. Kundërshtimi i së vërtetës duke pasur dije rreth saj, është një gjë më e rëndë sesa kundërshtimi duke mos pasur dije rreth saj.

“Dhe ky komentim i kësaj sure madhështore, është vetëm një pikë në oqean, ngase askush nuk mund të përfshijë të gjitha kuptimet e larta të saj.”